

Lënda: Mbi Programin e ri “Erasmus+2021-2027” dhe thirrjet e reja për propozime 2021

Drejtuar: Prof. Dr. Sokol Mëngjesi
Dekan i Fakultetit të Drejtësisë

Komisioni Evropian ka shpallur Programin e parë vjetor të Punës në kuadër të Programit të ri “Erasmus+ 2021- 2027”, dhe Thirjen për propozime 2021- EAC/A01/2021 që mbulon veprimet e Programit Erasmus+ lidhur me:

- Key Action 1 (KA1): Mobilitetet e individëve;
- Key Action 2 (KA2): Bashkëpunimi ndërmjet organizatave dhe institucioneve;
- Key Action 3 (KA3): Mbështetje për zhvillimin e politikave dhe bashkëpunimin;
- Programet Jean Monnet

Programi Erasmus+ 2021- 2027 ka një buxhet prej 26.2 miliardë eurosh dhe do të financojë mobilitetet dhe projektet e bashkëpunimit ndërkufitar. Fushat prioritare të tij janë të lidhura me tranzicionin e gjelbër dhe dixhital si dhe qëndrueshmërinë e sistemeve të arsimit dhe trajnimit përballë pandemisë. Thirrja e re për këtë vit në kuadër të Programit Erasmus+ ka një buxhet prej 2453.5 milion Euro.

Programi i ri Erasmus + ofron mundësi për periudha studimi jashtë vendit, aftësim dhe shkëmbime të stafit në të gjitha fushat e arsimit dhe trajnimeve si edhe për studentët e arsimit të lartë, shkëmbimet e të rinjve dhe punonjësit dhe trajnerët e rinj.

Afatet për dorëzimin e aplikimeve sipas fushave të veprimit janë si më poshtë:

KA1*	
Mobilitetet e individëve në fushën e arsimit të lartë	11 Maj, ora 12:00
Mobilitetet e individëve në VET, edukimin shkollor dhe fushat e edukimit të të rriturve	11 Maj, ora 12:00
Akreditimet Erasmus në VET, edukimin shkollor dhe fushat e edukimit të të rriturve	19 Tetor, ora 12:00
Mobilitetet e individëve në fushën e rinisë	11 Maj, ora 12.
Mobilitetet e individëve në fushën e rinisë	5 Tetor, ora 12.00

* UT nuk mund të aplikojë në kuadër të Credit Mobility KA1, por mund të bashkëpunojë me institucionet evropiane për të mundësuar rritjen e numrit të mobiliteteve të stafit dhe të studentëve nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve Ndërinstitucionale.

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza” Rektorati i UT, Tiranë, Tel: +355 4 258448



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR, PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE

KA2	
Partneritetet e bashkëpunimit në fushat e arsimit, trajnimit dhe rinisë, përveç atyre të paraqitura nga OJQ-të evropiane	20 Maj, ora 12:00
Partneritetet e bashkëpunimit në fushat e arsimit, trajnimit dhe të rinjtë e paraqitur nga OJQ-të evropiane	20 Maj, ora 17:00
Partneritetet e bashkëpunimit në fushën e sportit	20 Maj, ora 17:00
Qendra e Ekselencës Profesionale	7 Shtator, ora 17.00
Aleancat për inovacion	7 Shtator, ora 17.00
Veprimet Erasmus Mundus	26 Maj, ora 17.00
Ngritja e kapaciteteve në fushën e të rinjve	1 korrik, ora 17.00

KA3	
Të rinjtë evropianë së bashku	24 Qershor, ora 17:00
Programet dhe Rrjetet Jean Monnet	2 Qershor, ora 17.00

Për më tepër informacion më poshtë gjeni link-et mbi thirrjet si dhe Udhëzuesin e Programit Erasmus + 2021.

- Thirrjet për propozime 2021- EAC/A01/2021:
<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:C2021/103/11&from=EN>
- Fakte mbi Programin e ri Erasmus+ 2021-2027:
<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/ff1edfdf-8bca-11eb-b85c-01aa75ed71a1/language-en>
- Guida e Programit Erasmus+:
[file:///C:/Users/User/Downloads/2021-erasmusplus-programme-guide_en%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/2021-erasmusplus-programme-guide_en%20(1).pdf)
- Programi vjetor i punës 2021 për zbatimin e "Erasmus +" Programi i Unionit për Edukimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin:
https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/annual-work-programmes_en

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

